



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA Durrës  
KËSHILLI BASHKIAK

**PROÇESVERBAL**

**Nr. 18, datë 29.09.2022**

**I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës për muajin shtator, që zhvillohet në sallën e Këshillit Bashkiak**

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:08

Data e mbajtjes së mbledhjes : 29.09.2022

Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje e Radhës

**Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës:** Kryetarja e Bashkisë znj.Emiriana Sako dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

**Ani Dyrmishi:** Përshëndetje !

Të nderuar Këshilltarë! E nderuar Kryetare! Të nderuar të Pranishëm!

Deklaroj të hapur këtë mbledhje të radhës për muajin shtator.

Siç jeni vënë në dijeni nga sekretarja e këshillit nëpërmjet postës elektronike për rendin e ditës në këtë mbledhje do të marrim në shqyrtim projektvendime të propozuara nga kryetarja e bashkisë dhe 1 komision i këshillit. Ftoj sekretaren e këshillit të bëj prezencën në sallë.

**Dorina Milja:** Përshëndetje! Fillojmë me prezencën.

Jolanda Mustafaraj ... prezent.....deri tek.... Morena Boja...mungon.

Kryetar ke 31 këshilltarë në sallë, ke prezent dhe z. Valter Hoxha, i cili do të marrë mandatin e këshilltarit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Meqë kuorumi është i pranishëm, vazhdojme me mbledhjen.

Para se të fillojmë me leximin e pikave të rendit të ditës Ju bëj me dije se nga 5 vendime që kemi marrë mbledhjen e kaluar nga VKB nr.91-95, për Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 93, datë 06.09.2022 “Për miratimin përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për emergjencat civile, që i është alokuar Bashkisë Durrës për vitin 2022 në vlerën 51’984’331,06 lekë”, Prefekti i Qarkut Durrës me shkresë nr.700/4 prot, datë 15.09.2022, marrë në dorëzim nga Sekretariati Këshillit më datë 16.09.2022, është shprehur se ky vendim është i pabazuar në ligj, pasi sipas pikës 3.1, shkronja “dh” dhe “e” të VKM-së nr.414, datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, nuk parashikohet që bashkitë të përdorin fondin e kushtëzuar për mbrojtjen civile për blerje automjesh.

Pasi Bashkia të bëj ndryshimet përkatëse të projektvendimit dhe relacionit do ta fusim në mbledhjet e radhës.

Po kaloj në leximin e pikave të rendit të ditës. Sot për shqyrtim e miratim kemi 8 pika.

1. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit të Komisionit Mandateve	PËR MIRATIMIN E MANDATIT TË ANËTARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK Z. VALTER ABAZ HOXHA
2. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK NDIHMËN EKONOMIKE DERI 6% DHE FONDI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË DURRËS, PËR MUAJIN SHTATOR 2022
3. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 4,289,544 LEKË, TË ALOKUARA NGA BUXHETI I SHTETIT PËR RRRITJEN E PAGAVE PËR FUNKSIONIN E ARSIMIT PARASHKOLLOR
4. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E DETAJIMIT DHE PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 104.155.472 LEKË PA TVSH TË MBETUR PA PËRDORUR NGA FONDET E AKORDUARA ME VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.181, DATË 30.03.2022 “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIFORCIMIT TË NJËSIVE INDIVIDUALE TË BANIMIT DHE NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT), NË BASHKITË TIRANË, DURRËS, SHIJAK, LEZHË DHE KRUIJË”

#### **Shtesat**

Pika 5. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË ANEKSIN 1, BASHKËLIDHUR VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 22, DATË 25.02.2021 “PËR MIRATIMIN E LISTËS TË SUBJEKTEVE PËRFITUESE, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR PALLATIN NR.1062, RRUGA “26 NËNTORI” DHE PALLATIN NR.14,
---	--

	RRUGA “PETRAQ BOSHNJAKU”, NJËSIA ADMINISTRATIVE NR.2, TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019
Pika 6. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR T’U DREJTUAR KËSHILLIT TË MINISTRAVE PËR NJË NDRYSHIM TË VKM-SË NR. 431, DATË 15.05.2013 “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE PËRDORIM TË KOMUNËS KATUNDI I RI, TË QARKUT TË DURRËSIT” DHE MIRATIMIN E PËRDITËSIMIT PJESOR TË PRONËS ME EMËRTIMIN FUSHË SPORTI, ME VENDODHJE KATUNDI I RI, ZK 2117
Pika 7. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 54, DATË 31.05.2022, “PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR T’U DREJTUAR KËSHILLIT TË MINISTRAVE PËR NJË NDRYSHIM TË VKM-SË NR. 295, DATË 2.5.2012 “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS ISHËM, TË QARKUT TË DURRËSIT”, DHE MIRATIMIN E PËRDITËSIMIT PJESOR TË PASURISË ME EMËRTIMIN KOPSHTI BIZË, QË MBAN NR. 12 TË LISTËS SË TRANSFERIMIT”
Pika 8. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NJË SHTESE NË ANEKSIN NR. 1, BASHKËLIDHUR VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 32, DATË 26.03.2021, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR 4 BANESA KOLEKTIVE, L.17, RRUGA "LURA", PALLATET NR.1&3, DHE RRUGA "AHMET DAKLI", PALLATET NR.15&23, TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”, I NDRYSHUAR

Atëherë përsa i përket rendit të ditës kemi ndonjë koment?

Atëherë nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të rendit të ditës?

Kundra?

Abstenim ? .....Nuk ka.

*Atëherë me 31 vota pro miratohet rendi i ditës.*

- Kalojmë në projektvendimin e **pikës 1**, i japim fjalën Komisionit të Mandateve me Kryetare znj.Ana Dhamo.

**Ana Dhamo:** Faleminderit Kryetar! Përshëndetje të gjithëve!

Komisioni i Mandateve votoi pro projektvendimit dhe relacionit dhe vendosi ta kaloj për votim në mbledhjen e ditës së sotme. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit znj. Dhamo.

Z. Hoxha Ju ftoj të ngriheni në këmbë, unë do të lexoj formulën e betimit dhe Ju do të thoni “Betohem”.

*“Betohem në nderin tim se do të kryej me ndërgjegje detyrën e anëtarit të Këshillit Bashkiak dhe do t’i bindem Kushtetutës dhe ligjeve. Betohem se në të gjithë veprimtarinë time do të udhëhiqem nga interesat e shtetasve të Bashkisë Durrës dhe do të punoj me ndershmëri e përkushtim për zhvillimin dhe rritjen e mirëqenies së tyre”.*

**Valter Hoxha** : Betohem

**Ani Dyrmishi** : Komente përsa i përket pikës 1 të rendit të ditës, kemi nga ana e këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 1 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 31 vota pro miratohet pika 1 e rendit ditës.

Suksese dhe punë të mbarë z. Hoxha.

- Kalojmë në projektvendimin e **pikës 2**, i japim fjalën Komisionit të Barazisë Gjinore dhe Mirëqenies Sociale z. Petrit Ismailati.

**Petrit Ismailati**: Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Mirëqenies Sociale mori në shqyrtim pikën e 2 të rendit të ditës dhe vendosi ta kaloj atë për votim . Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit z.Ismailati.

Atëherë komente përsa i përket pikës 2 të rendit të ditës, kemi nga ana e këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 2 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 32 vota pro miratohet dhe pika 2 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin për **pikën 3**, i japim fjalën Komisionit të Buxhetit, Financës Taksave-Tarifave znj.Pamela Bardhaj.

**Pamela Bardhaj** : Komisioni i Buxhetit, Financës Taksave-Tarifave vendosi me të gjitha votat, pro miratimit të kësaj pike. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit znj.Bardhaj

Komisioni Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit, znj.Jolanda Mustafaraj.

**Jolanda Mustafaraj** : Përshëndetje!

Komisioni u mblodh dhe mori vendim që kjo pikë të kaloj. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit znj.Mustafaraj.

Komente përsa i përket pikës 3, kemi nga ana e këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 3 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 32 vota pro miratohet dhe pika 3 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit për **pikën 4**, i japim fjalën Komisionit të Buxhetit, Financës Taksave-Tarifave znj.Pamela Bardhaj.

**Pamela Bardhaj** : Edhe për këtë pikë komisioni ynë vendosi me të gjitha votat pro, të miratoj këtë pikë. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Velçani.

**Etleva Velçani** : Faleminderit Kryetar.

Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës mori në shqyrtim pikën 4 të rendit të ditës dhe vendosi me vota unanime për kalimin në votim. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Përsa i përket pikës 4 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 4 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 32 vota pro miratohet dhe pika 4 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit për **pikën 5**, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike z. Artion Beqiraj.

**Artion Beqiraj** : Faleminderit Kryetar.

Komisioni Rregullores, Çështjeve Ligjore shprehet pro kësaj pike.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit Beqiraj.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Budini.

**Etleva Budini** : Gjithashtu dhe Komisioni ynë vendosi unanimitisht për kalimin e kësaj pike për votim në mbledhjen e ditës së sotme.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Velçani.

**Etleva Velçani** : Faleminderit Kryetar.

Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës mori në shqyrtim pikën 5 të rendit të ditës dhe vendosi me vota unanime për kalimin në votim. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Atëherë komente përsa i përket pikës 5, kemi nga ana e këshilltarëve ?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 5 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë miratohet me 32 vota pro pika 5 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit për **pikën 6**, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike z. Artion Beqiraj.

**Artion Beqiraj** : Faleminderit Kryetar.

Komisioni Rregullores, Çështjeve Ligjore shprehet pro kësaj pike.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor z. Alfred Mullaraj.

**Alfred Mullaraj**: Komisioni ynë është dakort.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Atëherë përsa i përket pikës 6, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 6 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 32 vota pro miratohet dhe pika 6 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 7**, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike z. Artion Beqiraj.

**Artion Beqiraj** : Shprehemi pro kësaj pike.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor z. Alfred Mullaraj.

**Alfred Mullaraj**: Edhe Komisioni ynë është dakort.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit .

Përsa i përket pikës 7, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 7 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 32 vota pro miratohet dhe pika 7 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit për **pikën 8**, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike z. Artion Beqiraj.

**Artion Beqiraj** : Shprehemi pro.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Budini.

**Etleva Budini** : Gjithashtu dhe Komisioni ynë, vendosi për miratimin e një shtese në aneksin nr.1, bashkëlidhur vendimit të këshillit bashkiak nr. 32, datë 26.03.2021 dhe votoi unanimitisht për kalimin e kësaj pike për votim në mbledhjen e ditës së sotme. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit znj. Budini.

Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Velçani.

**Etleva Velçani** : Edhe Komisioni ynë i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës vendosi me vota unanime për kalimin në votim. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Përsa i përket pikës 8, ndonjë koment nga ana e këshilltarëve ka?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 8 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 32 vota pro miratohet dhe pika 8 e rendit ditës.

- **Diskutime**  
Meqë rendi ditës përfundoi, ka kërkuar fjalën znj. Jolanda Mustafaraj.

**Jolanda Mustafaraj** : E nderuar kryetare!

I nderuar kryetar i këshillit! Të nderuar koleg këshilltar!

Siç edhe jeni ne dijeni, misioni i Aleancës së këshilltarëve bashkiake është që të bashkojë gratë dhe burrat, anëtarë të këshillave bashkiake në Shqipëri, nga të gjitha partitë politike dhe të punojë për të zhvilluar dhe advokuar për legjislacion, politikë, zhvillim ekonomik dhe nisma të tjera që i

përgjigjen çështjeve, që prekin nevojat e grave dhe komunitetin, rritjen e barazisë gjinore dhe përfshirjes sociale. Aleanca synon të promovojë barazinë gjinore dhe përfshirjen sociale, të drejta të barabarta, qasjen e barabartë në shërbime dhe mundësi ekonomike në qeverisjen lokale.

Aleanca ka për qëllim që së bashku të ndikojmë në përmirësimin dhe hartimin e politikave lokale të favorshme për gratë dhe grupet e tjera të pafavorizuara në komunitetet e tyre.

Aleanca e këshilltareve të bashkisë Durrës, është bashkimi i grave përfaqësuese të mazhorancës dhe opozitës, si dhe grave aktive në jetën e qytetit të Durrësit. Ajo vepron në partneritet të ngushtë me Komisionin e Barazisë Gjinore.

Në këtë kontekst, me lejoni që në cilësinë e kryetares së Aleancës së këshilltareve të bashkisë Durrës t'ju përcjell një informacion të shkurtër në lidhje me aktivitetet, fushatat ndërgjegjësuëse si edhe iniciativave që kjo Aleancë, së bashku me mbështetjen e gjithmontë dhe gadishmërinë e kryetares dhe administratës së bashkisë sonë ka arritur.

Në mbështetje të misionit dhe qëllimit të saj, Aleanca e këshilltareve të bashkisë Durrës vetëm gjatë këtij viti ka mbështetur dhe ka ndërmarrë këto iniciativa:

Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale i Këshillit Bashkiak Durrës, në përmbushje të rolit të tij, ka ndërmarrë një iniciativë me karakter social dhe gjinor në shërbim të komunitetit të bashkisë Durrës, i cili e monitorojë përgjatë fund vitit 2021. Kjo nismë mori shkas nga nënkryetari i Komisionit të Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale z. Petrit Ismailati dhe u mbështet nga të gjithë anëtarët e komisionit dhe të aleancës njëkohësisht.

Në kuadër të mbështetjes së vazhdueshme për personat me status Verbërie dhe status Para-Tetraplegjie, Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale kërkoi reduktimin e tarifave të regjistrimit të fëmijëve në çerdhe dhe kopshte për kategoritë duke u parashikuar në lehtësirat fiskale për vitin 2021 si më poshtë:

1. Përfshirjen nga tarifa e regjistrimit për çerdhe dhe kopshte për fëmijët të cilët të ëmën e kanë kryefamiljare dhe me status Verbërie dhe status Para-Tetraplegjie.
2. Përgjysmimin e tarifës së regjistrimit për çerdhe dhe kopshte për fëmijët të cilët njërin nga prindërit e kanë me status Verbërie ose status Para-Tetraplegjie.

Si dhe një kërkesë e miratuar në këshill bashkiak për:

3. Mbështetje për vajzat dhe gratë viktime të dhunës apo trafikimit nëpërmjet pagesës së qirasë së një mjedisi ku ato mund të strehohen për një kohë të caktuar.

Gjithashtu, në muajin gusht, Aleanca kombëtare e këshilltareve ka ndërmarrë fushatën ndërgjegjësuëse “Përfshihu për qytetin tënd”. Nëpërmjet kësaj fushate “Ne” synuam dhe duam që zëri i qytetarëve të sjellë ndryshime në praktikën e përzgjedhjes së kandidatëve dhe temave të trajtuara në programet politike (përfshirë median) për zgjedhjet vendore të 2023.

Ne synojmë që qytetarët të jenë aktivë e të përfshihen në çështjet e qeverisjes vendore duke qenë paraprakisht të përgatitur për procesin e ardhshëm zgjedhor. Në kuadër të kësaj fushate e nisme “Ne” hartuam një pyetësor me alternativa të mundshme mbi cilësitë dhe kriteret që duhet të plotësojë një profil kandidati për këshilltar bashkiak. Deri më sot, rreth 1000 qytetarë kanë përcjellë mendimin e tyre përmes përgjigjeve të administruara prej kryesisë së Aleancës Kombëtare të Këshilltareve.

Disa nga kriteret të cilat mund t'i citoj janë:



1. Cilësi menaxheriale të mira të imazhit publik në një garë elektorale. Një platformë e qartë elektorale nga një figurë e pastër e kandidatit potencial.
2. Aftësi shumë të mira komunikuese me zgjedhësit duke shërbyer si një urë komunikimi ndërmjet zgjedhësve dhe këshillit bashkiak për çështjet kombëtare e lokale me aftësi shumë të mira për të dëgjuar pikëpamje të ndryshme dhe njëkohësisht i qartë për dhe në vendimmarrje.
3. Aftësi shumë të mira të të kuptuarit të çështjeve politike, të të kuptuarit dhe identifikuarit të nevojave të komunitetit duke i artikuluar dhe mbrojtur interesat e komunitetit në komisionet e këshillit, mbledhjet dhe më gjerë.
4. Mbështetës i fortë i parimeve demokratike, me integritet dhe standarte të larta morale. Aftësi shumë të mira përshtatëse për punën në grup dhe njëkohësisht dhe me partitë e tjera.

Gjykojmë në këtë kuptim shumë të nevojshëm faktin e prezantimit të këtyre kritereve për të tërhequr edhe një herë vëmendjen e aktoreve vendimmarrës që të mund të konsiderohen në momentin e përzgjedhjes së kandidatëve për zgjedhjet e ardhshme lokale.

Aleanca e Zgjeruar e Këshilltareve Durrës, është tashmë faktor dhe aktor, i përkushtuar për të forcuar demokracinë lokale dhe për të çuar përpara agjendat kombëtare e lokale për barazinë gjinore dhe përfshirjen sociale.

Faleminderit.

**Ani Dyrmishi:** Faleminderit znj. Mustafaraj.

Për diskutim nuk e ka kërkuar këshilltarë tjetër fjalën, kështu që mbledhjen e deklaroj të mbyllur dhe për mbledhjen e radhës do të njoftoheni nga sekretaria e këshillit.

*Ky procesverbal mbyllet me nr. rendor 9 (nëntë) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset nga Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit, sipas Rregullores Këshillit dhe Procesverbalit të Kryesisë dhe 2 Kryetarëve të Grupeve Politike në Këshill së datës 09.06.2022.*

**Mbajtësi i procesverbalit:** Dorina Milja

**Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit :**

Kryetar i Këshillit Bashkiak :	ANI DYRMISHI
Zëvendëskryetare e Këshillit :	ZAMIRA MUSTAFARAJ ( <i>mungon</i> )
Sekretare e Këshillit Bashkiak :	DORINA MILJA
Kryetar i Grupit të Partisë Socialiste të KB :	AFRIM BAKAJ
Kryetar i Grupit të Pavarur të KB :	ETLEVA VELÇANI